



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 150

10 shtator

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8302 datë 10.9.2013	Për emërimin e Kryeministrit.....	6489
Urdhër i MD nr. 334, datë 28.8.2013	Për përdorimin dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor (ALBIS), si dhe përcaktimin e subjekteve që kanë të drejtë ta aksesojnë atë.....	6489
Urdhër i MD nr. 358, datë 5.9.2013	Për tarifat e transkriptimit të procesverbalit të seancës gjyqësore, të mbajtur me mjete të regjistrimit audio ose audioviziv.....	6494
Urdhër i MD nr. 359, datë 5.9.2013	Për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore apo të veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë seance..	6495
Urdhër i MD nr. 360, datë 5.9.2013	Për mënyrën e njoftimit elektronik të akteve gjyqësore.....	6496

DEKRET
Nr. 8302, datë 10.9.2013

PËR EMËRIMIN E KRYEMINISTRIT

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 96, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë, me propozim të partive që kanë shumicën e vendeve në Kuvend,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Edi Rama emërohet Kryeministër i Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

URDHËR
Nr. 334, datë 28.8.2013

**PËR PËRDORIMIN DHE HEDHJEN E TË DHËNAVE NË SISTEMIN E MENAXHIMIT
ELEKTRONIK TË ÇËSHTJEVE TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR (ALBIS), SI DHE
PËRCAKTIMIN E SUBJEKTEVE QË KANË TË DREJTË TA AKSESOJNË ATË**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 6, shkronjës “a” të nenit 21 dhe nenit 26 të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, të shkronjës “b” të nenit 10, shkronjës “b” të nenit 32 dhe nenit 36 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 443, datë 16.6.2011 “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor (ALBIS)”,

URDHËROJ:

I. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij urdhri është përcaktimi:

a) i detyrimeve të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor, lidhur me zbatimin me përpikëri të rregullave për regjistrimin, ruajtjen, ndryshimin, transferimin dhe arkivimin e të dhënave në formë elektronike, në sistemin ALBIS, të krijuar me vendimin nr. 443, datë 16.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor (ALBIS)”;

b) i rregullave për kontrollin e veprimtarisë së Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor për zbatimin e detyrimit për hedhjen e të dhënave në sistemin ALBIS, si dhe sanksioneve të zbatueshme në rastin e evidentimit të shkeljeve të përcaktimeve të bëra në këtë urdhër;



c) i subjekteve që kanë të drejtë të aksesojnë sistemin ALBIS, si dhe nivelin e aksesit të tyre.

2. Në këtë urdhër, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “ALBIS” është sistemi i menaxhimit elektronik i çështjeve të përbarimit gjyqësor, krijuar me vendimin nr. 443, datë 16.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përbarimit gjyqësor (ALBIS)”, sipas versionit të përmirësuar të tij dhe që administrohet nga Ministria e Drejtësisë;

b) “Bankë qendrore” janë të dhënat në hapësirën e ruajtjes së informacionit të përbaruesit gjyqësor, tek e cila nuk mund të kenë akses subjekte të tjera;

c) “Faza teknike” është ndarja logjike e çështjes që ka si qëllim organizimin sa më efikas të dokumenteve dhe të të dhënave të tjera që nevojiten gjatë ndjekjes së procedurës përbarimore;

ç) “Përbarues gjyqësor” përfshin përbaruesin gjyqësor shtetëror dhe përbaruesin gjyqësor privat.

3. Aksesit në sistemin ALBIS realizohet nëpërmjet një adrese të veçantë në internet, e cila i komunikohet përbaruesit gjyqësor nga Ministria e Drejtësisë.

3.1 Aksesit në sistem sigurohet me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin përkatës, në përputhje me kredencialet personale të secilit përdorues.

3.2 Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi fillestar i jepen në mënyrë konfidenciale çdo përbaruesi në rrugë zyrtare nga Ministria e Drejtësisë.

3.3 Sistemi ALBIS ofron për çdo përdorues mundësinë e ndryshimit në çdo moment të fjalëkalimit dhe garanton ruajtjen e fshehtësisë së tij. Ruajtja dhe përdorimi i fjalëkalimit është nën përgjegjësinë vetjake të përdoruesit.

II. RREGULLAT PËR HEDHJEN E TË DHËNAVE

4. Përbaruesi gjyqësor përdor detyrimisht sistemin ALBIS për regjistrimin e të dhënave të përcaktuara në pikën 3 të vendimit nr. 443, datë 16.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përbarimit gjyqësor (ALBIS)”.

5. Çështjet e ardhura pranë zyrës përbarimore shtetërore regjistrohen brenda 5 ditëve nga depozitimi i tyre nga Kryetari i Zyrës së Përbarimit Shtetëror, pas kontrollit ligjor të dokumentacionit, si dhe në përputhje me nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile.

5.1 Kryetari i Zyrës së Përbarimit Gjyqësor Shtetëror, brenda 2 ditëve pas regjistrimit të çështjes në sistem, përcakton përbaruesin gjyqësor shtetëror përgjegjës për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

5.2 Nëse përbaruesi gjyqësor ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, çështja rindahet, duke evidentuar nëpërmjet një shënimi në sistem për arsyet e ekzistencës së konfliktit të interesit.

6. Përbaruesi gjyqësor privat, regjistron çështjen në sistemin ALBIS, pasi merr përsipër ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, duke respektuar nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile. Përbaruesi gjyqësor privat bën regjistrimin e çështjes brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës me palën kreditore.

7. Përbaruesi gjyqësor pas regjistrimit të çështjes fillon menjëherë me trajtimin e saj sipas legjislacionit në fuqi, si dhe me procedimin e çështjes në sistemin elektronik.

7.1 Procedimi i një çështjeje në sistemin elektronik përfshin mbledhjen dhe hedhjen e informacioneve të nevojshme, përcaktimin e palëve, kontakteve, dokumenteve të punës dhe ndjekjes së të gjitha fazave dhe proceseve të punës që lidhen me të.

7.2 Një çështje procedohet duke kaluar nëpër disa faza teknike të programuara në sistem. Përbaruesi gjyqësor, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile përfundon çdo fazë me shënimin përkatës në sistem, si dhe duke hedhur të gjitha dokumentet e punës brenda 10 ditëve nga marrja e çdo vendimi apo përpilimit të çdo akti.

8. Në sistemin ALBIS ruhen të dhënat e çështjeve përbarimore. Subjekti që i hedh këto të dhëna, nëse është e nevojshme, plotëson ose korrigjon informacionin e regjistruar me nivelin më të lartë të kujdesit profesional.

8.1 Përbaruesi është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të hedhura prej tij.

8.2 Saktësia e të dhënave kontrollohet përpara përfundimit të një çështjeje.

9. Dosja përbarimore mbyllet elektronikisht në përputhje me vendimin e përbaruesit gjyqësor, sipas Kodit të Procedurës Civile. Përbaruesi gjyqësor, pas momentit të mbylljes përfundimtare të dosjes përbarimore, nuk mund të ndryshojë më të dhënat në sistem. Çështja arkivohet automatikisht në sistemin ALBIS.

III. RREGULLAT PËR RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE

10. Të gjitha të dhënat e çështjeve përbarimore ruhen në një bankë qendrore të dhënash. Baza e sistemit të ruajtjes së informacionit përfshin një tërësi të plotë të të gjitha informacioneve që janë të nevojshme për procedimin e çështjeve.

10.1 Çdo zyrë përbarimore/përbarues ka hapësirën e vet të mbyllur në sistemin e ruajtjes së informacionit. Aksesi në këtë hapësirë është i ndaluar për përdorues të tjerë të të njëjtit nivel.

10.2 Veprimet e çdo përbaruesi gjyqësor në sistemin ALBIS pasqyrohen dhe ruhen në Regjistrin e Veprimeve Elektronike me Sistemin (RIV). RIV ruhet dhe nuk fshihet nga sistemi ALBIS.

11. Të dhënat e ruajtura në sistemin ALBIS mund t'u vihen në dispozicion palëve të treta për të plotësuar detyrimin për informim, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

11.1 Informacioni për çështje përbarimore mund t'u jepet pas kërkesës me shkrim vetëm:

a) organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;

b) strukturave të tjera shtetërore lidhur me çështjet pasurore të debitorëve;

c) përbaruesve të tjerë, vetëm nëse informacioni është i nevojshëm për procedurat e ekzekutimit;

ç) kreditorit, i cili ka depozituar për ekzekutim një titull ekzekutiv;

d) kur personi, për të cilin kërkohet informacioni, jep pëlqimin.

11.2 Informacioni për çështjet përbarimore, i cili nuk lejohet të jepet me gojë apo me shkrim, nuk mund të transferohet edhe elektronikisht.

12. Të dhënat dhe informacioni i ruajtur në sistemin ALBIS mund të riprodhohen, kopjohen ose shumëfishohen vetëm për qëllimet e parashikuara në këtë urdhër, si dhe në legjislacionin në fuqi.

12.1 Përdoruesit e sistemit nuk mund të ndërhyjnë dhe t'i ndryshojnë modulet e programeve informatike.

12.2 Letrat e printuara me gabime ose printime të dyfishta, lidhur me të dhënat e palëve në proces, fshihen në mënyrë të sigurt, nëse nuk nevojiten dhe nuk përdoren për veprimtarinë e kërkuar. E njëjta gjë vlen për pajisjet e ruajtjes së të dhënave, si: disqe, flash disqe, të cilat nuk përdoren më.

12.3 Mekanizma të mbrojtjes së të dhënave nga aksesi i paautorizuar, të tilla si: fjalëkalimet, mekanizmi i fjalëkalimit, gjatësia e fjalëkalimit, periodiciteti i ndryshimit të fjalëkalimit, kufizimi i përsëritjes së fjalëkalimeve, përcaktohen nga struktura përgjegjëse e teknologjisë së informacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

IV. AKSESI NË SISTEMIN ALBIS

13. Sistemi ALBIS administrohet nga Ministria e Drejtësisë, që në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbikëqyr:

a) performancën e përbaruesve gjyqësorë;

b) inspektimin e procedurave ligjore lidhur me çështjet përbarimore;

c) organizimin dhe menaxhimin e mirë të punës.

13.1 Ministria e Drejtësisë ka të drejtën e aksesit për të gjitha çështjet përbarimore.



13.2 Aksesimi i sistemit nga Ministria e Drejtësisë bëhet kryesisht për të mbikëqyrrur:

- a) ndjekjen e procedurave ligjore dhe eficiente gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutivë;
- b) mbarëvajtjen gjatë proceseve të punës;
- c) marrëdhëniet me palët;
- ç) përdorimin në përputhje me të gjitha kërkesat funksionale të sistemit ALBIS;
- d) raportimet dhe analizat e përpunuara nga sistemi.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit ka të drejtën e aksesit në të gjitha çështjet e përmbarrimit gjyqësor shtetëror.

15. Kryetari i zyrës vendore të përmbarrimit gjyqësor shtetëror ka të drejtë aksesit në të gjitha çështjet e zyrës së tij. Aksesit bëhet kryesisht për:

- a) regjistrimin e dosjes si fazë para ndarjes së çështjes;
- b) përcaktimin e përmbarruesit që do të ndjekë çështjen;
- c) zëvendësimin e përmbarruesit të ngarkuar me çështjen;
- ç) transferimin e çështjes në një zyrë tjetër.

16. Inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, anëtarët e këshillit përmbarrimor dhe anëtarët e komisionit disiplinor kanë të drejtë aksesit në çështjet që inspektojnë apo verifikojnë.

17. Përmbarruesi gjyqësor ka të drejtën e aksesit në sistem vetëm për çështjet përmbarrimore në ngarkim të tij për ekzekutim.

18. Bankat e nivelit të dytë, në cilësinë e kreditorit, kanë të drejtën e aksesit në sistem vetëm për çështjet përmbarrimore të depozituara për ekzekutim prej tyre. Aksesit i sistemit, në këtë rast, bëhet vetëm nga një person, i cili i njoftohet paraprakisht Ministrisë së Drejtësisë.

V. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E SUBJEKTEVE

19. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për teknologjinë e informacionit, ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) Kujdeset për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit ALBIS, me qëllim garantimin e funksionimit të tij dhe mbështetjes së shërbimit përmbarrimor për përdorimin e sistemit;
- b) Shërben si pikë qendrore kontakti për përmbarruesit gjyqësorë apo stafin IT të zyrave përmbarrimore, në rast të problematikave teknike të paraqitura nga sistemi;
- c) Jep këshilla dhe transferon ankesat e ardhura nga përmbarruesit gjyqësorë pranë strukturës/subjektit përgjegjës për mirëmbajtjen e sistemit ALBIS;
- ç) Ofron mbështetje teknike për përdoruesit e sistemit ALBIS dhe shqyrton kërkesat e përdoruesve për ndryshime dhe përmirësime të vazhdueshme të sistemit ALBIS;
- d) Monitoron dhe vlerëson nëpërmjet kontraktimit mënyrën e mirëmbajtjes, zhvillimit dhe realizimit të detyrave të tjera nga struktura/subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit. Struktura/subjekti përgjegjës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit zbaton rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale dhe mbrojtjes së konfidencialitetit. Përveç detyrës për të zgjidhur probleme të veçanta të përcaktuara qartë për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit, nuk ka të drejtë të hyjë në serverin e bankës qendrore të të dhënave që të marrë të dhëna personale apo në lidhje me çështje të caktuara përmbarrimore, të transferojë të dhëna të marrës të jashtëm, të ndryshojë të dhëna ose të ndërhyjë në përpunimin e të dhënave nga përdoruesit.

20. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror, në përputhje me legjisllacionin në fuqi, ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) mbikëqyr performancën e përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë;
- b) inspekton procedurat ligjore të ndjekura nga përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë lidhur me çështjet përmbarrimore;
- c) mbikëqyr organizimin dhe menaxhimin e mirë të punës nga zyrat vendore dhe përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë.

21. Të dhënat statistikore përpunohen dhe transferohen nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit dhe Dhoma Kombëtare e Përmbarruesve Privatë, vetëm për qëllime që janë brenda kompetencave dhe detyrave të tyre ligjore.

22. Përmbarruesi gjyqësor ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) Përdor detyrimisht sistemin ALBIS për hedhjen e të dhënave për çdo çështje përmbarrimore, sipas rregullave të përcaktuara në këtë urdhër;

b) Njofton menjëherë strukturën përgjegjëse për teknologjinë e informacionit në Ministrinë e Drejtësisë për çdo problem të hasur gjatë përdorimit të sistemit ALBIS, duke kërkuar asistencën e saj për zgjidhjen e problemit;

c) Merr pjesë në trajnimet e zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë për mënyrën e përdorimit të sistemit;

ç) Ruan konfidencialitetin e të dhënave të hedhura në sistemin ALBIS.

23. Bankat e nivelit të dytë kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) Përdorin sistemin ALBIS sipas rregullave të përcaktuara në këtë urdhër, vetëm për çështjet përmbarrimore të depozituara për ekzekutim prej tyre;

b) Ruajnë konfidencialitetin e të dhënave që gjenden në sistemin ALBIS.

24. Moshedhja e të dhënave për çdo çështje përmbarrimore nga përmbarruesi gjyqësor apo kryetari i zyrës vendore të Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror, si dhe moszbatimi i rregullave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje disiplinore në kuptim të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor" dhe ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat", të ndryshuar.

25. Shkeljet për përmbarruesit gjyqësorë shtetërorë klasifikohen si më poshtë vijon:

a) Moshedhja e të dhënave të plota apo mosprocedimi i çështjes në sistemin elektronik, brenda afatit, për më pak se 5 çështje përmbarrimore, përbën shkelje disiplinore dhe ndaj tij merret masë disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra", sipas shkronjës "b" të paragrafit 1 të nenit 31 të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor";

b) Moshedhja e të dhënave të plota apo mosprocedimi i çështjes në sistemin elektronik, brenda afatit, për 5 apo më shumë çështje përmbarrimore, apo moshedhja e të dhënave pasi është marrë më parë masë disiplinore sipas shkronjës "a" të kësaj pike, përbën shkelje të rëndë disiplinore në kuptim të shkronjave "b" dhe "c" të paragrafit 1 të nenit 35 të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor" dhe ndaj tij merret masa disiplinore "Shkarkim nga detyra", sipas shkronjës "c" të paragrafit 1 të nenit 31 të këtij ligji.

26. Shkeljet për kryetarin e zyrës vendore të përmbarrimit gjyqësor shtetëror klasifikohen si më poshtë vijon:

a) Mosregjistrimi i të dhënave të plota apo mosndarja e çështjeve brenda afatit për më pak se 5 çështje përmbarrimore, përbën shkelje disiplinore dhe ndaj tij merret masë disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra", sipas shkronjës "b" të paragrafit 1 të nenit 31 të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor";

b) Mosregjistrimi i të dhënave të plota apo mosndarja e çështjeve brenda afatit për 5 apo më shumë çështje përmbarrimore apo mospërbushja e detyrimeve pasi është marrë më parë masë disiplinore sipas shkronjës "a" të kësaj pike, përbën shkelje të rëndë disiplinore në kuptim të shkronjave "b" dhe "c" të paragrafit 1 të nenit 35 të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor" dhe ndaj tij merret masa disiplinore "Shkarkim nga detyra", sipas shkronjës "c" të paragrafit 1 të nenit 31 të këtij ligji.

27. Shkeljet për përmbarruesit gjyqësorë privatë klasifikohen si më poshtë vijon:

a) Moshedhja e të dhënave të plota apo mosprocedimi i çështjes në sistemin elektronik, brenda afatit, për më pak se 5 çështje përmbarrimore, përbën shkelje disiplinore në kuptim të



shkronjës “dh” të nenit 52 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, të ndryshuar, dhe ndaj tij merret masë disiplinore “Gjobë nga 30 000 deri 50 000 lekë”, sipas shkronjës “b” të nenit 54 të këtij ligji;

b) Moshedhja e të dhënave të plota apo mosprocedimi i çështjes në sistemin elektronik, brenda afatit, për 5 apo më shumë çështje përmbartimore apo moshedhja e të dhënave, pasi është marrë më parë masë disiplinore, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, përbën shkelje të rëndë disiplinore në kuptim të shkronjës “a” të nenit 52 të ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, të ndryshuar dhe ndaj tij merret masë disiplinore “Heqje e licencës dhe çregjistrim nga regjistri”, sipas shkronjës “a” të nenit 54 të këtij ligji.

28. Mosrespektimi i përgjegjësive sipas këtij urdhri nga bankat e nivelit të dytë përbën shkak për heqjen e së drejtës së aksesit në sistemin ALBIS. Struktura përgjegjëse e teknologjisë së informacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë, për çdo shkelje të evidentuar njofton menjëherë Ministrin e Drejtësisë. Heqja e së drejtës së aksesit bëhet me urdhër të veçantë të Ministrit të Drejtësisë.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

29. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, në Ministrinë e Drejtësisë, merr të gjitha masat që sistemi ALBIS të funksionojë, si dhe brenda datës 1 shtator 2013, të pajisë të gjithë përmbartuesit gjyqësorë të papajisur më parë, si dhe subjektet që kanë të drejtë aksesit në sistem sipas këtij urdhri me kredencialet e aksesimit të sistemit ALBIS (emër, përdoruesi dhe fjalëkalimi). Çdo përmbartues i papajisur me kredencialet e aksesimit të sistemit ALBIS, duhet të paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e kredencialeve brenda datës 5 shtator 2013.

30. Përmbartuesit gjyqësorë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, hedhin të dhënat e plota për të gjitha çështjet përmbartimore që janë në ngarkim të tyre apo që janë ekzekutuar prej tyre deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

31. Drejtoria e Përgjithshme e çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë, të ndjekë zbatimin e këtij urdhri, duke ushtruar kontrole të herëpashershme mbi përdorimin e sistemit ALBIS nga përmbartuesit gjyqësorë. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë të marrë masat për planifikimin e një kontrolli tematik, menjëherë pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 30 të këtij urdhri.

32. Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror marrin të gjitha masat e nevojshme për njoftimin e këtij urdhri të gjithë përmbartuesve gjyqësorë, si dhe mbikëqyrin mënyrën e zbatimit të tij.

33. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR Nr. 358, datë 5.9.2013

PËR TARIFAT E TRANSKRIPTIMIT TË PROCESVERBALIT TË SEANCËS GJYQËSORE, TË MBAJTUR ME MJETE TË REGJISTRIMIT AUDIO OSE AUDIOVIZIV

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 118/1 germa “b” të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Tarifat për transkriptimin e procesverbaleve të seancës gjyqësore, në rastet kur transkriptimi bëhet me kërkesë të palëve në gjykim ose personave të tjerë të interesuar, janë si më poshtë:

- a) Transkriptimi i një fragmenti nga procesverbali i seancës gjyqësore - 500 lekë;
- b) Transkriptimi i një procesverbali të seancës gjyqësore - 1500 lekë.

2. Transkriptimi me kërkues të trupit gjykues nuk i nënshtrohet tarifës.

3. Palëve në gjykim ose personave të tjerë të interesuar u jepet transkriptimi i procesverbalit të seancës gjyqësore, vetëm pasi vërtetojnë pagimin e tarifës së transkriptimit.

4. Ngarkohen gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR

Nr. 359, datë 5.9.2013

**PËR RUAJTJEN DHE ARKIVIMIN E PROCESVERBALIT TË SEANCËS GJYQËSORE
APO TË VEPRIMEVE TË TJERA PROCEDURALE QË ZHVILLOHEN JASHTË SEANCE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 118 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Procesverbali i seancës gjyqësore apo i veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë seance, të mbajtura nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv apo në formën e një përmbledhjeje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim, si pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore, arkivohet dhe ruhet për aq kohë sa ruhet vetë dosja gjyqësore.

2. Rregullat për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të mbajtur nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, përcaktohen në udhëzimin nr. 353, datë 3.9.2013 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”.

3. Procesverbali i mbajtur në formën e një përmbledhjeje me shtypshkrim apo dorëshkrim ruhet në dosjen gjyqësore dhe arkivohet duke ndjekur rendin kronologjik të akteve në dosjen gjyqësore, në bazë të nënshkrimit të sekretares gjyqësore, si dhe me vulën e gjykatës. Atij mund t’i bashkëlidhen edhe shpjegimet dhe pretendimet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, në përputhje me nenin 172 të Kodit të Procedurës Civile.

4. Palët, personat e tretë të thirrur në gjykatë, si dhe personat e interesuar mund të tërheqin kopje të procesverbaleve të arkivuara në dosje, të regjistrimeve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive, transkripte të plota ose të pjesshme të këtyre të fundit, si dhe ekstrakte autentike të akteve të përpiluara me shtypshkrim apo dorëshkrim kundrejt pagesës dhe me lejen e gjykatës në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 77 të Kodit të Procedurës Civile.



5. Në çdo rast, e drejta e palëve dhe e publikut për t'u njohur me dosjen gjyqësore përfshin edhe të drejtën për t'u njohur me procesverbalin e seancës gjyqësore.
 6. Ngarkohen gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit për zbatimin e këtij urdhri.
 7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
 8. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR
Nr. 360, datë 5.9.2013

PËR MËNYRËN E NJOFTIMIT ELEKTRONIK TË AKTEVE GJYQËSORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, si dhe nenit 141 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Njoftimi elektronik, si një ndër mënyrat e njoftimit të akteve gjyqësore bëhet nga nëpunësi gjyqësor nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik dhe ndiqet nga gjyqtari ose kryetari i trupit gjykues të çështjes, i cili kontrollon dhe kujdeset për procesin e zhvillimit të tij në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.
2. Thirrja në gjykatë, nëpërmjet lëtrëthirrjes, urdhërohet të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik, në rast se çmohet e dobishme nga gjykata dhe kur pala ka dhënë pëlqimin paraprak, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.
3. Njoftimi elektronik bëhet me mjete të komunikimit elektronik që mundësojnë marrjen e konfirmimit për mbërritjen/marrjen e njoftimit ose nëse kjo është e pamundur përsoni i thirrur duhet të konfirmojë personalisht që ka marrë njoftimin.
4. Njoftimi elektronik i paditësit ose përfaqësuesit të tij, bëhet vetëm në rastin kur në kërkesëpadi janë paraqitur të dhënat elektronike të kontaktit, si dhe deklarata e pranimit të njoftimit me mjete të komunikimit elektronik.
5. Në rast se vërtetohet nga nëpunësi gjyqësor se paditësi ose përfaqësuesi i tij ka ndryshuar të dhënat elektronike të kontaktit të tij dhe gjykata nuk është njoftuar për të dhënat e reja elektronike të kontaktit të tij, në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 158/a të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi bëhet në formë shkresore në një kohë sa më të shpejtë. Në rast se edhe të dhënat e adresës së paditësit ose përfaqësuesit të tij, kanë ndryshuar dhe gjykata edhe në këtë rast nuk është njoftuar nga paditësi ose përfaqësuesi i tij për adresën e re, në kushtet e mosrespektimit të detyrimit për njoftimin e të dhënave të reja nga paditësi, pretendimet e tij lidhur me pavlefshmërinë e njoftimit do të konsiderohen të papranueshme.
6. Për njoftimin e vendimit të gjykatës ndiqen të njëjtat rregulla, të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij urdhri.

7. Në çdo rast, njoftimi bëhet duke respektuar legjislacionin për komunikimet elektronike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Njoftimi pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, i cili hartohet dhe përmban elementet e parashikuara në nenin 141 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe bëhet pjesë e dosjes gjyqësore.

9. Për arkivimin dhe ruajtjen e procesverbalit të njoftimit ndiqen të njëjtat rregulla si për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur në formën e një përmbledhjeje me shtypshkrim apo dorëshkrim.

10. Ngarkohen gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.

12. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 10.9.2013
Doli nga shtypi më 10.9.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 18 lekë